

**FORMULAR APLIKIMI PËR ULJEN 50%
NGA TARIFA E SHKOLLIMIT PËR VITIN 2021 - 2022**

EMËR ATËSI MBIEMËR	
PROGRAMI & VITI I STUDIMIT (MASTER)	
1. Master Shkencor <input type="checkbox"/> 2. Master Profesional <input type="checkbox"/>	
NR. PERSONAL	
NR. I MATRIKULLIMIT	
NUMËR CEL/TEL	
KATEGORIA QË I PËRKET SIPAS “ <u>VKM-së nr. 780, datë 26.12.2018</u> “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, institucionet publike të arsimit të lartë”.	
<p>1. Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë; *Dokumentat shoqëruese:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vendim i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë; • Vërtetimi origjinal nga njësia e vetëqeverisjes vendore për masën e pagesës së paaftësisë që merr studenti; • Vërtetim shkollë nga sekretaritetë mësimore, ku duhet të jetë e specifikuar dega që studenti ndjek, viti, fakti nëse studenti është përsëritës apo jo; • Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë). 	
<p>2. Studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore; * Dokumentat shoqëruese:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vendim i KMCA-së për punë i familjarit me aftësi të kufizuar; • Vërtetimi origjinal nga njësia e vetëqeverisjes vendore për masën e pagesës së paaftësisë që merr familjari me aftësi të kufizuar; • Vërtetim i ndihmës ekonomike të plotë apo të pjesshme, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore; • Vërtetim shkollë nga sekretaritetë mësimore, ku duhet të jetë e specifikuar dega që studenti ndjek, viti, fakti nëse studenti është përsëritës apo jo; • Certifikatë familjare; • Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë). 	
<p>3. Studentët familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore; * Dokumentat shoqëruese:</p>	

<ul style="list-style-type: none"> • Vërtetim i ndihmës ekonomike të plotë apo të pjesshme, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore; • Vërtetim shkollë nga sekretaritetë mësimore, ku duhet të jetë e specifikuar dega që studenti ndjek, viti, fakti nëse studenti është përsëritës apo jo; • Certifikatë familjare; • Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë). 	
<p>4. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;</p> <p>* Dokumentat shoqëruese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Dokument/e që vërteton/jnë se të ardhurat vjetore të familjes janë të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve (ku përfshihen: 1. vërtetim papunësie e prindit që jeton ose nëse është në punë vërtetim pagese; 2. Vërtetim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Rajonale Gjiroakster që aplikanti dhe të gjithë familjarët e tij nuk kanë pronë/prona, përveç banesës që jeton, nëse disponon; 3. Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjiroakster, që aplikanti dhe të gjithë familjarët e tij nuk kanë biznes në emër të tyre; 4. Si dhe çdo dokument tjetër që aplikanti (familja e tij ka) që vërtetojnë të ardhura të pamjaftueshme); <input type="checkbox"/> Vërtetim shkollë nga sekretaritetë mësimore, ku duhet të jetë e specifikuar dega që studenti ndjek, viti, fakti nëse studenti është përsëritës apo jo; <input type="checkbox"/> Certifikatë vdekjeje e prindit të ndarë nga jeta; <input type="checkbox"/> Certifikatë familjare; <input type="checkbox"/> Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë). 	
<p>5. Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;</p> <p>* Dokumentat shoqëruese:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fotokopje e noterizuar e librezës së statusit të jetimit, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror; • Vërtetim shkollë nga sekretaritetë mësimore, ku duhet të jetë e specifikuar dega që studenti ndjek, viti, fakti nëse studenti është përsëritës apo jo; • Certifikatë familjare; • Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë). 	
<p>6. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;</p> <p>* Dokumentat shoqëruese:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vendimi i gjykatës i formës së prerë për humbjen e kujdestarisë prindërore; • Vërtetim shkollë nga sekretaritetë mësimore, ku duhet të jetë e specifikuar dega që studenti ndjek, viti, fakti nëse studenti është përsëritës apo jo; • Certifikatë familjare; • Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë). 	

7. Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore;

*** Dokumentat shoqëruese:**

- Vërtetim për përfitimin e statusit ligjor për trajtim si viktimë e trafikut të qenieve njerëzore nga Drejtoria e Përgjithshme Antitrafik në Ministrinë e Brendshme;
- Vërtetim shkolle nga sekretaritetë mësimore, ku duhet të jetë e specifikuar dega që studenti ndjek, viti, fakti nëse studenti është përsëritës apo jo;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

8. Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria/institucioni përgjegjës;

*** Dokumentat shoqëruese:**

- Vërtetim apo dokument tjetër nga ministria/institucioni përgjegjës që konfirmon se studenti është fëmijë i punonjësit të Policisë së Shtetit/të Gardës së Republikës/të Shërbimit të Kontrollit për çështjet e Brendshme dhe Ankesat/të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin/të Forcave të Armatosura/të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që ka humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;
- Vërtetim shkolle nga sekretaritetë mësimore, ku duhet të jetë e specifikuar dega që studenti ndjek, viti, fakti nëse studenti është përsëritës apo jo;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

9. Studentët romë dhe ballkano-egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;

*** Dokumentat shoqëruese:**

- Deklaratë noteriale nga studenti që vetëdeklaroi të qenurit e tij rom apo ballkano-egjiptian si dhe një vërtetim që ekziston i regjistruar si i tillë.
- Vërtetim shkolle nga sekretaritetë mësimore, ku duhet të jetë e specifikuar dega që studenti ndjek, viti, fakti nëse studenti është përsëritës apo jo;
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

10. Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;

*** Dokumentat shoqëruese:**

- Dokument që vërteton përkatësinë në këtë shtresë sociale, lëshuar nga shoqata e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë;
- Vërtetim shkolle nga sekretaritetë mësimore, ku duhet të jetë e specifikuar dega që studenti ndjek, viti, fakti nëse studenti është përsëritës apo jo;
- Certifikatë familjare;

<ul style="list-style-type: none"> Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë). 	
--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--

- Autorizoj Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokaster, për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit tim si dhe publikimin e tyre.
- Autorizoj Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokaster, për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.
- Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i/e vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

DOKUMENTET E DORËZUARA

<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>

STUDENTI/JA

MARRËSI NË DORZIM

EMËR/MBIEMËR/NËNSHKRIMI

NËNSHKRIMI
